



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE
SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Prefekti i Qarkut Fier Nr.Prot. 255/, Data 27.02.2024

Shkurtimi i lëndës Kthim përfundimor për verifikimin e llogjshmërisë së
Vendimit Nr.12- të Këshillit të Bashkisë Roskovec
të miratuar në mbledhjen e datës 19.02.2024

Për trajtim nga:	<u>Vendimi Nr.12- të Këshillit të Bashkisë Roskovec të miratuar në mbledhjen e datës 19.02.2024</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	<u>Delina Hoxha</u> <u>Arlenda Hoxha</u> <u>8.7.2024</u> <u>2 Selman Cepole</u>

Afati: normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/ për dje/ Tjetër me

Data 29.02.2024, Nr.Prot 1086/

Nënshkrimi: (TITULLARI) _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim specialisti: _____

Me porosinë: _____

- Trajtim i materialit përfunduar më: _____, Specialisti
- Trajtim i materialit pranuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
- Trajtim i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
- Trajtim i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 255 / Prot.

Fier, më 27.02.2024

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 12, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 19.02.2024.

BASHKISË ROSKOVEC
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC

Roskovec

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 1086 prot. datë 20.02.2024, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 255 prot. datë 26.02.2024, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut" neni 8, shkronja "a", neni 16, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, pasi shqyrtuam vendimin e Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 19.02.2024, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 2, datë 19.02.2024, i mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 69, prot. datë 05.01.2024, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimit, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 12, datë 19.02.2024, "Për një shtesë dhe transferime në buxhetin e vitit 2024" është dërguar i shoqëruar nga projektvendimi Nr. 12, datë 12.02.2024, protokolluar me Nr. 894 prot. datë 12.02.2024, relacioni shpjegues Nr. 894/1 prot. datë 12.02.2024, dhe relacioni shpjegues Nr. 894/2 prot. datë 12.02.2024.

Në bazë të ligjit Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut" neni 8, shkronja "a", prefekti verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 12, datë 19.02.2023, "Për një shtesë dhe transferime në buxhetin e vitit 2024" nuk është një vendim tërësisht normativ. Dispozitivi i tij përmban edhe rregullime që nuk janë aspak të karakterit normativ. Në vendim është miratuar shtesë në buxhet nga të ardhurat e trashëguara dhe rishpërndarje në buxhet që kanë karakter normativ, por gjithashtu janë miratuar edhe disa përdorime fondesh, për projekte dhe detyrime të prapambetura. Miratimi i përdorimit të këtyre fondeve në të njëjtin vendim me miratimin e ndryshimeve në buxhet, cënon karakterin normativ të vendimit.

Vendimi i këshillit bashkiak që miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij në bazë të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 54, shkronja "dh", përbën akt me karakter normativ dhe si i tillë prefekti shprehet për ligjshmërinë e tij.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec bie në kundërshtim me nenin 3, pika 2, e ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", për sa i përket përkufizimit dhe formës së aktit normativ. Aktet që trajtohen në këshill duhet të jenë qarta në formë dhe në përmbajtje. Aktet me karakter normativ nuk duhet të miksohen me akte të tjera të llojeve të ndryshme, pasi ky veprim çënon karakterin e aktit normativ nënligjor. Në hierarkinë e akteve, për sa i përket fuqisë juridike, akti nënligjor normativ qëndron më lartë dhe miratimi i një vendimi në këtë formë siç e keni miratuar ju e ulë fuqinë juridike të aktit, në nivelin e aktit administrativ individual, duke rritur edhe mundësinë që mund të atakohet në gjykatë nga një numër edhe më i madh subjektesh të interesuara. Për sa më sipër:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 12, datë 19.02.2024, "Për një shtesë dhe transferime në buxhetin e vitit 2024" ju kthehet si vendim që bie në kundërshtim me ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" nenit 3, pika 2.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Rajmonda Ballaj

